



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullore MF- nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Doracakut të Procedurave të MFK-së pika 4 – Procedurat e MFK-së Nr.4 – Menaxhimi i Rrezikut si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR CAKTIMIN E KOORDINATORËS PËR IDENTIFIKIMIN DHE VLERËSIMIN E
RREZIKUT PËR VITIN 2023 SIPAS PROCEDURAVE TË MFK-SË

Neni 1

Me këtë Vendim, **Shehadije Ibrahim**, zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa **CAKTOHET**, Koordinatorë për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut për vitin 2023 sipas procedurave të MFK-së.

Neni 2

Nëpunësja civile e caktuar në nenin 1 të këtij Vendimi, do të kryej punët dhe detyrat si detyrë shtesë krahas detyrave të punës, konform Rregullores MF- nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe Doracakut të Procedurave të MFK-së.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe dhe Nëpunësja civile e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

1Nr. 112/02-61784
Lipjan, më 01.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR CAKTIMIN E ZYRTARËVE PËRGJEGJËS PËR APLIKIM NË OGP

Neni 1

Me këtë Vendim, caktohen zyrtarët përgjegjës për aplikim në OGP Lokale , në përbërje si vijon:

1. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës,
2. Imri Semetishti, Drejtor i Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,
3. Anila Reçica Llugiqi, Drejtoreshë e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 2

Zyrtarët e cekur në nenin 1 të këtij vendimi janë zyrtarë përgjegjës për aplikim për tu anëtarësuar në Open Government Partnership (OGP) Lokale për Komunën e Lipjanit për përgaditjen e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim në OGP Lokale, në bashkëpunim me ekspertët e angazhuar nga USAID KMI.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin Zyrtarët përgjegjës të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

1Nr. 020/01-63830
Lipjan, më 14.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Ndhmën Shtetërore Nr.05/L-100, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke vepruar konform Shkresës së dërguar përmes emailit zyrtar me datë 23.02.2023 të Departamentit të Ndhmës shtetërore në Republikën e Kosovës në kuadër të Ministrisë së Financave , Punës dhe Transfereve, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM
PËR CAKTIMIN E ZYRTAREVE PËRGJEGJËSE

I.Me këtë Vendim CAKTOHEN, zyrtare përgjegjëse nga Komuna e Lipjanit dhe persona kontaktues me Departamentin e Ndhmës Shtetërore në kuadër të Ministrisë së Financave , Punës dhe Transfereve, zyrtaret komunale si vijon:

1. Shehide Sopa Ibrahim, Drejtorati për Buxhet dhe Financa
2. Merita Zeqiri, Drejtorati për Infrastrukturë

II. Zyrtaret e cekura në nenin I të këtij do ti kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë dhe do të jenë persona kontaktues nga Komuna e Lipjanit me Departamentin e Ndhmës Shtetërore për të raportuar për skemat e ndihmës shtetërore apo Deminimis dhe njëkohësisht do të jenë "përdorues të sistemit" për të pasur qasje në system në mënyrë që të bëhet njoftimi i ndihmës.

III Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen zyrtaret përgjegjëse dhe Departamenti i ndihmës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Financave , Punës dhe Transfereve . Me hyrjen në fuqi të këtij shfuqizohet Vendimi për caktimin e zyrtareve përgjegjëse 01-112/02-14062 i datës 20.03.2023.

1Nr. 020/p1-66045
Lipjan, më 30.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 4 dhe 7 të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për kompensimin për funksionin shtesë, pikës 8 të Qarkores së Ministrisë së Punëve të Brendshme Nr.Ref 356/2023 të dates 21.03.2023 rreth zbatimit të Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për kompensimin për funksione shtesë, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

VENDIM

PËR EKZEKUTIMIN E PAGËS PËR KOMPENSIMIN E PUNËS TË KOMITETIT TË AUDITIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

I. MIRATOHET, Vendimi për kompensimin e punës të Komitetit të Auditimit të Komunës së Lipjanit për tri takimet e mbajtura gjatë vitit 2023 me datat: **29.01.2023, 20.04.2023, dhe 24.07.2023.**

II. OBLIGOHET, Drejtorati për Buxhet dhe Financa që konform, Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e Komitetit të Auditimit 1Nr.020/04-30942 të datës 15.06.2023 të bëjë kompensimin e anëtarëve të Komitetit për Auditim prej 30% të pagës bazë të Zyrtarit Kryesor Administrativ të Komunës për kryesuesin e komitetit dhe 20 % për anëtarët e komitetit sipas ekstrakteve -procesverbaleve të takimeve të mbajtura.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Sektori për Personel.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe i njëjti i dërgohet për zbatim Drejtoratit për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 120/02-65916
Lipjan, më 29.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 44 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, nenit 17 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) nr.25/2020 për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPI PUNUES PËR PLTËSIMIN E DRAFT-PLANIT PËR VLERËSIMIN E RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Përbërja

Formohet, grupi punues për plotësimin e Draft-Planit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit, duke u bazuar në shkresën e Ministrisë së Punëve të Brendshme për vlerësimin e ligjshmërisë nr.01 të dates 10.01.2023, në përbërje si vijon:

1. Burim Rrustemi, Kryesues
2. Rafete Retkoceri, anëtare
3. Gafurr Hetemi, anëtar
4. Vlora Krasniqi, anëtare
5. Albert Mustafa, anëtar
6. Bekim Zaskoku, anëtar
7. Jalldyze Gashi, anëtare
8. Afrim Sadiku, anëtar
9. Behar Mjeku, anëtar
10. Enver Elshani, anëtar
11. Brahim Duriqi, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë që në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse të plotësojë Draft- Planin për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit duke u bazuar në shkresën e

Ministrisë së Punëve të Brendshme për vlerësimin e ligjshmërisë nr.01 të dates 10.01.2023.

2. Pas finalizimit të Draft- Planit, grupi punues është i obliguar që draftin final përmes Kryetarit të Komunës ta dërgojë paraprakisht në AME -Agjencia e Menaxhimit Emergjent për shqyrtim profesional dhe përmbajtësor dhe pas marjes së opinionit nga AME e procedon për miratim në Kuvendin Komunal.
3. Punët administrative – teknike për grupin punues do t'i kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Draft-Planit për për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit 1Nr.020/04-52669/2 i datës 17.10.2022.

1Nr.020/01-64449

Lipjan, më 16.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet grupi punues për aplikim në OGP Lokale , në përbërje si vijon:

1. Bukurie Zejnullahu, Shefe e Sektorit për Marëdhënie me Publikun, Kryesuese,
2. Linda Shahini, Zyrtare për Integritim Evropian , anëtare
3. Islam Kaleshi, zyrtar ligjor, anëtar
4. Bekim Krasniqi, anëtar nga Shoqëria Civile, anëtar
5. Fadil Sopa , nga subjektet e biznesit, anëtar

Neni 2

Grupi punues ka për detyrë dhe përgjegjësi që të jap kontributin profesional në takimet e organizuara për përgaditjen e dokumentacionit përkatës për aplikim, për tu anëtarësuar Komuna e Lipjanit në Open Government Partnership (OGP) Lokale, në bashkëpunim me Zyrtarët përgjegjës të Komunës dhe me ekspertët e angazhuar nga USAID KMI. Mandati i grupit punues fillon me datën 13.11.2023 dhe mbaron me datë 12.01.2024.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin Grupi punues.

1Nr. 020/01-63859
Lipjan, më 14.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 14 Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22599 të datës 28.04.2023 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR BURSAT E
STUDENTEVE

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit për vitin akademik 2023/2024, Nr.4-670/01-61519 datë 30.10.2023, në këtë përbërje:

1. Islam Kaleshi, Zyrtar Ligjor në Sektorin për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, Kryesues
2. Fatbardha Shurdhiqi, Zyrtare në Drejtoratin për Infrastruktur, anëtare
3. Albulena Salihu, Zyrtare në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësit

1. Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimin e ankesave të studenteve të cilët janë ankuar ndaj listës preliminare Nr.4-670/01-61519 datë 30.10.2023 të shpallur nga Komisioni vlerësues për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Lipjanit për vitin akademik 2023/2024. Komisioni do të shqyrtoj ankesat në bazë dispozitive të Rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 si dhe Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e bursave për student të Komunës së Lipjanit Nr.15-670/01-22599 të datës 28.04.2023.
2. Punët teknike administrative për Komisionin do të kryhen nga Drejtorati për Arsim.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe më të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-62610
Lipjan, më 06.11.2023





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet komisioni për shqyrtimin e rekomandimeve të auditorit për pasqyrat financiare për vitin 2022, në përbërje si vijon:

1. Shemsi Azemi, Kryesues,
2. Visar Kozhani, anëtar
3. Sabedin Bajrami, anëtar

Neni 2

Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi që të merret me shqyrtimin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit duke gjetur praktikat procedurale të nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të auditorit sipas raportit të auditimit për vitin 2022.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin kryesuesi dhe anëtarët e komisionit.

1Nr. 020/01-66047
Lipjan, më 30.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, Kryetari i Komunës nxjerr,

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT –PLANIN E PUNËS TË EKIPIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËS (2024-2026)

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Plani i Punës i Ekipit për të drejtat e fëmijës (2024-2026)

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft- Plan mund ti dërgohen Komisionit për hartimin e Draft- Planit të Punës të Ekipit për të drejtat e fëmijës 2024-2026 ose në email adresën shkelzen.hajdini@rks-gov.net, më së largu me datë 17.12.2023.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 183/01-64631
Lipjan, më 17.11. 2023





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) br.03/2020 za Transparentnost u Opštinama, Administrativno Uputstvo (MUP) br.06/2018 o minimalnim standardima javnih konsultacija u opštinama, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan Br. 15-353-35739, dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA
O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT-PLAN RADA TIMA ZA PRAVA DETETA
2024-2026

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt- Plan rada tima za prava deteta 2024-2026 u Opštini Lipljan

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt –Plan mogu se poslati Radnoj Komisiji za izradu Projekt – Plan rada tima za prava deteta 2024-2026 na email adresu: shkelzen.hajdini@rks-gov.net naj kasnije do 17.12.2023.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 183/01-64631
Lipljan, 17.11.2023





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, Kryetari i Komunës nxjerr,

VENDIM
MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT- PLANIN E VEPRIMIT PËR
TRANSPARENCË 2023-2027 NË KOMUNËN E LIPJANIT

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Plani i Veprimit për transparencë 2023-2027 në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft- Plan mund ti dërgohen Komisionit për hartimin ne Draft- Planit të Veprimit për transparencë 2023-2027 ose në email adresën bukurie.zejnullahu@rks-gov.net, më së largu me datë 17.12.2023.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës .

1Nr. 016/01-64634
Lipjan, më 17.11 2023





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Uputstva (MUP) br.03/2020 za Transparentnost u Opštinama, Administrativno Uputstvo (MUP) br.06/2018 o minimalnim standardima javnih konsultacija u opštinama, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan Br. 15-353-35739, dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA
O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT-AKCIONI PLAN ZA TRANSPARENTNOS U
OPŠTINI LIPLJAN

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt- Akcioni Plan za Transparentnos u Opštini Lipljan

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt –Plan mogu se poslati Radnoj Komisiji za izradu Projekt – Akcioni Plan za Transparentnos u Opštini Lipljan na email adresu: bukurie.zejnullahu@rks-gov.net naj kasnije do 17.12.2023.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br. 016/01-64634
Lipljan, 17.11.2023





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të për projektin Festivali për Fëmijë “Lipjani 2023” Nr.5-453/01-62940 të datës 07.11.2023, Rekomandimit të komisionit vlerësues Nr.1-052/09-63081 të datës 08.11.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR PROJEKTIN FESTIVALI PËR FËMIJË
“LIPJANI 2023”

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,000.00 €** (shtatëmijë euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-në “Evolution Dance” për realizimin e aktiviteteve për projektin Festivali për Fëmijë “Lipjani 2023”, sipas projektit që ka aplikuar në bazë të Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-52274 e datës 13.09.2023.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna Festivali për Fëmijë “Lipjani 2023”:

Nr.	Emërtimi i OJQ-së	Shuma
1.	OJQ-në SH.K.A. “Minatori i Ri Kizhnicë”	7,000.00 €
	Shuma Totale	7,000.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen me Kontratë të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.052/09-63081
Lipjan, më 10.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,560.00€**, (shtatë mijë e pesqindë e gjashtëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-61743 e datës 01.11.2023, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 27 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin tetor të vitit 2023 me nga 280 euro për secilin rast $27 \times 280 = 7,560.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-61743
Lipjan, më 03.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 4, 8 dhe 11 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe Rregullores së Kuvendit të Komunës me 15Nr.110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, duke vendosur sipas kërkesës 1Nr.400/01-62090 të datës 02.11.2023 të Bashkësisë Islame dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr këtë:

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **2000€** (dy mijë euro), sipas kërkesës së Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan, për të mbështetur financiarisht për realizimin e projektit për ndërtimin e Xhamisë qendrore në Lipjan sipas kërkesës së tyre 1Nr.400/01-62090 të datës 02.11.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023 pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Bashkësisë Islame në nr. 17192000190037882 në NLB Bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell raport - dëshmi deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport më së largu me datë 25.12.2023.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet BIK-u dega në Lipjani.

1Nr.400/01-62090
Lipjan, më 07.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 6 të Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022 duke u bazuar në Njoftimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursa për student Nr.04-670/01-64022 të datës 15.11.2023, Kryetari i Komunes nxjerr:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 1Nr.670/01-52871 TË DATËS 14.09.2023 PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË BURSAVE DHE SHUMËS FINANCIARE PËR NJË BURSË PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK-SHKOLLOR 2023/2024

Neni 1

Me këtë Vendim, ndryshohet dhe plotësohet neni 1 i Vendimit 1Nr.670/01-52871 i datës 14.09.2023 për caktimin e bursave dhe shumës financiare për një bursë përkatësisht shtohet edhe dy (2) bursa nga 170 (njëqind e shtatëdhjetë) bëhen 172 (njëqind e shtatëdhjetë e dy) në bazë të Rekomandimit - Njoftimit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursa për student Nr.04-670/01-64022 të datës 15.11.2023.

Pas plotësimit dhe ndryshimit neni 1 i Vendimit 1Nr.670/01-52871 i datës 14.09.2023 për caktimin e bursave dhe shumës financiare për një bursë, riformulohet si vijon:

Me këtë Vendim CAKTOHET që për vitin akademik 2023/2024 të ndahen 172 (njëqind e shtatëdhjetë dhjetë e dy) bursa dhe shuma financiare për një bursë do të jetë 500 € (pesëqind) euro.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Drejtorati për Arsim.

1Nr. 670/01-52871/2
Lipjan, më 15.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin përfundimtar të komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të (klubet sportive paralimpik) Nr.5-453/01-55239 të datës 26.09.2023, Rekomandimit të Komisionit vlerësues Nr.1-400/01-55964 të datës 29.09.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ - TË (KLUBET SPORTIVE
PARALIMPIK) PËR VITIN 2023

Neni 1

Me këtë Vendim, plotësohet neni 2 i Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për OJQ-të (Klubet Sportive Paralimpik) për vitin 2023, 1Nr.400/01-55964 i datës 02.10.2023 dhe riformulohet si në vijim:

Neni 2 - Shuma e cekur në nenin 1 të Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për OJQ- të (klubet sportive paralimpik) për vitin 2023, 1Nr.400/01-55964 i datës 02.10.2023, do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Drejtorati për Administratë.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorati për Administratë dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.400/01-55964/2
Lipjan, më 29.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 par. 9 të Rregullores MF –Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 si dhe Rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.01-400-63635 i datës 13.11.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TJETËRSIMIN-ASGJËSIMIN E OBJEKTEVE TË VJETRA TË KOMUNËS

Neni 1

TË ASGJËSOHEN- RRËNOHEN, objektet e vjetra, në pronësi komunale në bazë të Rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.01-400-63635 të datës 13.11.2023.

Objektet e vjetra të rekomanduara për asgjësim janë si vijon:

1. Objekti i vjetër i Komunës me numër të njësisë kadastrale 01733-0-43-0,
2. Baraka e vjetër me numër të njësisë kadastrale 01740-5-37-0,
3. Objekti me numër të njësisë kadastrale 01743-3-35-0,
4. Objekti me numër të njësisë kadastrale 0128-1, 0128-2

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Administratë dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Administratë, Drejtorati për Prokurim dhe Zyrtari për pasuri.

1Nr. 400/01-63635
Lipjan, më 15.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 par. 9 të Rregullores MF –Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 si dhe Rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.01-400-63630 i datës 13.11.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
PËR TJETËRSIMIN-ASGJËSIMIN E OBJEKTEVE TË VJETRA KOMUNALE TE
QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE NË LIPJAN

Neni 1

TË ASGJËSOHEN- RRËNOHEN, objektet e vjetra, në pronësi komunale të cilat gjenden afër objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan në bazë të Rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.01-400-63630 të datës 13.11.2023.

Objektet e vjetra të rekomanduara për asgjësim janë si vijon:

1. Aneksi ku është vendosur Stomatologjia me nr. të njësisë kadastrale 0-01179-1-96-0,
2. Aneksi ku është vendosur Materniteti me nr. të njësisë kadastrale 0-01179-1-9-0,
3. Aneksi I Urgjencës me nr. të njësisë kadastrale 0-01179-1-95-0

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtorati për Prokurim dhe Zyrtari për pasuri.

1Nr. 400/01-63630
Lipjan, më 15.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për OJQ "Zëri i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve me Nr.15-453/01-61652 të datës 30.10.2023, konform edhe dispozitave të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe OJQ "Zëri i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve Nr.01-610/01-60676 të datës 24.10.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **6.000.00 €** (gjashtë mijë euro), për të vepruar konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për OJQ "Zëri i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve me Nr.15-453/01-61652 të datës 30.10.2023 dhe dispozitave të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe OJQ "Zëri i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve Nr.01-610/01-60676 të datës 24.10.2023.

Neni 2

Ndarja e mjeteve të cekura në nenin 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.01-610/01-60676 të datës 24.10.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve qëllimi i së cilës është vazhdimi i funksionalizimit të qendrave mësimore përmes mbështetjes financiare të drejtpërdrejtë nga Organizata "Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve" konkretisht shuma e cekur ndahet për subvencionimin e funksionimit të Qendrës mësimore në shkollën SH.F.M.U "Haradin Bajrami" në Magurë".

Neni 3

OJQ " Zëri i Romëve, Ashkalinjeve dhe Egjiptianve" ka për detyrë në fund të realizimit të programit të përgatis raport financiar mbi shpenzimin mjeteve financiare të transferuara nga Komuna e Lipjanit për Organizatën " Zëri i Romëve, Ashkalinjeve dhe Egjiptianve"

Neni 4

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 për Drejtoratin për Arsim në xhirollogarinë bankare nr XK051167002199050185 të Organizatës “ Zëri i Romëve, Ashkalinjeve dhe Egjiptianëve” në ProCredit Bank.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorati për Arsim.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Arsim.

1Nr. 400/01-66043

Lipjan, më 30.11.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW) me Nr.15-400/01-53381 të datës 15.09.2023, konform edhe dispozitave të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW) IRW Kosovo Office Nr.01-413/01-44206 të datës 17.08.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1. Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **50.024.00 €** (pesëdhjetë mijë euro e njëzet e katër cent), për të vepruar konform Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW) me Nr.15-400/01-53381 të datës 15.09.2023 dhe dispozitave të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW).

2.Ndarja e mjeteve të cekura në paragrafin 1 të këtij neni bëhet me qëllim të përmbushjes së gjysmës apo 50% të obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Nr.1-413/01-44206 të datës 17.08.2023 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Islamic Relief Worldwide zyra në Kosovë (IRW) me të cilën Komuna e Lipjanit do të participojë 43.87% të vlerës totale ndërsa pjesa e dytë apo 50% e obligimeve do të ekzekutohen vitin e ardhshëm me një Vendim tjetër që do ti propozohet Kuvendit të Komunës për miratim.

Neni 2

Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW) do ti raportoj me shkrim Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, lidhur me veprimet e ndërmarra konform dispozitave të Marrëveshjes ku përfshihet Raporti financiar lidhur me mjetet e shpenzuara dhe arsyetimi i tyre me fatura dhe dokumentacion tjetër përkatës.

Neni 3

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhirollogarinë bankare nr 1708200008014285 në NLB Banka të Islamik Relief Worldwide-Zyra në Kosovë (IRW).

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 400/dl-64032

Lipjan, më 15. 11. 2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, në zbatim të nenit 12 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e brendshëm të financave publike Kryetari i Komunës merr

VENDIM

- Formohet grupi punues për identifikimin, vlerësimin dhe përcaktimin e veprimeve ndaj rrezikut në procesin e planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve nga të drejtoratet përkatëse të Komunës së Lipjanit, në përbërje prej:
 - Shehadije Ibrahim, Koordinatore e grupit punues,
 - Armend Duriqi, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
 - Burim Gashi, Drejtorati për Administratë
 - Visar Kozhani, ZKF
 - Islam Kaleshi, Zyra e Kryetarit të Komunës-Sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore
 - Jetmir Bytyqi, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm, Mbrojtje dhe Shpëtim
 - Bekim Arifi, Drejtorati për Prokurim
 - Teuta Berisha, Drejtorati për Arsim
 - Shqipe Rexhepi, Drejtorati për Inspeksion
 - Linda Shahini, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim
 - Merita Zeqiri, Drejtorati për Infrastrukturë
 - Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
 - Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari
 - Alban Bytyqi, QKMF
 - Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport
 - Behar Krasniqi, Zyra e Avokatit publik komunal
 - Gafurr Hetemi, Zyra e Kryetarit të Komunës-Sektorit pronësor-juridik
 - Halit Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Sektorit për Tatim në Pronë
 - Fauz Xhemajli, Sektorit i gjendjes Civile
- Obligohen të gjitha Drejtoratet përkatëse të Komunës që në procesin e planifikimit për vitin 2024 të parashohin riksun dhe menaxhimin e tij;
- Grupi punues obligohet të hartoj Listën dhe Planin e menaxhimit të rreziqeve në Komunën e Lipjanit.
- Afati kohor për identifikimin e Listës së rreziqeve është data 15 dhjetor 2023.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohet Koordiantoria dhe anëtarët e tjerë të grupit punues.

1Nr. 020/04-61845
Lipjan, më 01.11. 2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

